



Revistë
elektronike

qershor
2017

Edukim seksual gjithëpërfshirës për një jetë premtuese

Të rejat më të fundit

1. Seminare me prindër

Dyzet prindër nga zonat rurale të Tiranës morën pjesë në dy seminare me titull "Të flasim lirshëm rreth seksualitetit". Në këto seminare prindërit mësuuan dhe u aftësuan sesi të bisedojnë me fëmijët rreth shëndetit seksual riprodhues, rreth sjelljeve të rrezikshme dhe mënyrave sesi këto sjellje mund të zvogëlohen. Falë diskutimeve të frutshme, prindërit pranuan se duhet të shqetësohen realisht kur fëmijët nuk kanë njohuri rreth seksualitetit. Mesazhi kryesor i seminareve ishte se vetëm mësimi, aftësimi, inteligjenca për seksualitetin janë bazat për t'u përkujdesur për veten dhe të tjerët, për të krijuar marrëdhënie të kuptimta, të qëndrueshme dhe të përshtatshme sociale dhe intime. Prindërit pjesëmarrës i ndanë mësimet e marra në këto seminare me 120 prindër të tjerë.



Pas përpjekjeve shumë vjeçare, edukimi seksual në Shqipëri është bërë pjesë e sistemit para-universitar bazuar në udhëzues ndërkombëtarë, të cilët janë një produkt bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe bashkëpunëtorëve të tjerë.

QSHPHZ ka qenë një pjesë e qenësishme e këtyre përpjekjeve dhe arritjeve. Në periudhën 2016-2017, me mbështetjen e Federatës Ndërkombëtare të Planifikimit Familjar - (IPPF), qendra PO" në Tiranë dhe qendra "Aulona" në Vlorë (pjesë të QSHPHZ) po zbatojnë projektin: "Edukim seksual gjithëpërfshirës për një jetë premtuese". Pas përfshirjes së edukimit seksual në shkolla, qendra pa të arsyeshme të ndërmarrë ndërhyrje të mëtejshme me fokus:

- Mundësimin e një mjedisi mbështetës ndaj seksualitetit të rinjve duke rritur informimin e prindërve, mësuesve, medias dhe vendim-marrësve për rëndësinë që ka edukimi seksual në përgatitjen e fëmijëve me njohuritë e duhura për seksualitetin dhe trupin e tyre, inteligjencën emocionale dhe aftësitë për jetën për një të ardhme të shëndetshme dhe më të sigurt.
- Arritjen e grupeve në nevojë, duke ofruar informacion dhe shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues atje ku ata jetojnë; duke i përfshirë këto grupe në hartim, zbatim dhe monitorim të aktiviteteve.

Këto ishin arsyt pse QSHPHZ filloi zbatimin e këtij projekti.

2. Seminare me të rinjtë

Njëqind të rinj (13-24 vjeç) duke përfshirë edhe të rinjtë nga komunitet rom, egjiptian, të rinjtë LGBT dhe ata që jetojnë në zonat rurale morën pjesë në seminarin me temë: seksualiteti dhe të qenit të ndryshëm; seksualiteti pozitiv, të drejtat dhe gjinia etj. Të rinjtë kuptuan se të drejtat seksuale janë të drejta njerëzore dhe që një i ri të rritet i shëndetshëm dhe i lumtur duhet të ketë njohuri për fizikun dhe seksualitetin si edhe të zhvillojë inteligjencën emocionale dhe aftësinë për t'u kujdesur për veten gjatë marrëdhënieve sociale dhe intime. Këta të rinj do të përfshihen në sesione të edukimit bashkëmoshatar për të arritur sa më shumë të rinj të tjerë përmes edukimit seksual.



Një vajzë 13 vjeçe:

Tani unë jam e ndërgjegjshme se seksualitet nuk do të thotë thjeshtë seks, por njohuritë për të na ndihmojnë të mbrojmë shëndetin dhe dinjitetin

1. Shkolla verore “Edukim Seksual Gjithëpërfshirës për një jetë premtuese!”



Stafi i qendrës “PO” së bashku me vullnetarët organizuan shkollën verore katër ditore (7-10 qershor 2017), me temë “Edukim Seksual Gjithëpërfshirës për një jetë premtuese!” në ambjentet e hotel Horizonti në Durrës. Njëzet të rinj duke përfshirë të rinj nga grupet në

nevojë përfituan edukim/informim sesi të shmangin sjelljet e rrezikshme, si të krijojnë marrëdhënie të shëndetshme sociale dhe intime; si të mendojnë në mënyrë kritike, si të kujdesen për veten; si dhe ku mund të marrin shërbimet miqësore për të rinjtë për një shëndet më të mirë dhe jetë të lumtur.

Cjatë sesioneve praktike pjesëmarrësit hartuan disa plane për jetën e tyre. Këto plane përfshinë regjistrimin në shkollë; shmangien e martesës së hershme; mbrojtjen nga shtatzënitë e paqëllimshme, infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe HIV/SIDA; përdorimin e kontracepsionit, shmangien e përdorimit të drogës apo alkolit etj.



Konferenca Ndërkombëtare—Edukimi Seksual: Mësimet e Nxjerra dhe Zhvillimet në të Ardhmen në Rajonin Evropian të Organizatës Botërore të Shëndetësisë—Berlin, Maj 2017

Stafi i QSHPZH, Brunilda Hylviu dhe Edlira Sina nga Instituti për Zhvillimin e Arsimit morën pjesë në konferencën ndërkombëtare Edukimi Seksual: Mësimet e Nxjerra dhe Zhvillimet në të Ardhmen në Rajonin Evropian të Organizatës Botërore të Shëndetësisë të zhvilluar në Berlin, në muajin maj.

Shqipëria një histori suksesi - edukimi seksual gjithëpërfshirës në shkolla, përfshirja e tij në sistemin arsimor para-universitar; përpjekjet afatgjata të QSHPZH, IPPF, UNFPA; mbështetja dhe angazhimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve; bashkëpunimi me partnerë të tjerë - këto ishin pikat kyçe të prezantimeve që QSHPZH ndau me pjesëmarrësit përgjatë zhvillimit të konferencës.

